



CIMC – 2009/03

Rregullore për pajtueshmërinë me obligimet e të drejtës së autorit

Preambula:

Respektimi i të drejtës dhe praktikës ndërkontaktare në lidhje me mbrojtjen e pronës intelektuale duke përfshirë, por jo kufizuar në, audio dhe video materialet argëtuese është vendimtar për zhvillimin e konkurrencës së rregullt dhe të drejtë në tregun medial. Një treg medial, i rregulluar në përputhje me standartet dhe praktikat më të mira, është thelbësor për zhvillimin e një ekonomie të tregut në Kosovë.

Pirateria transmetuese, respektivisht prodhimi, shpërndarja, shitja apo transmetimi i paligjshëm i materialeve që janë objekt i marrëveshjeve ndërkontaktare mbi mbrojtjen e pronës intelektuale, është një formë e konkurrencës jo të drejtë në tregun e mediave. Përveç dëmitimit të rëndë të interesave të autorëve dhe pronarëve të tjera të të drejtave dhe provokimit të rrezikut për kundërmasa ndërkontaktare të tregtisë, pirateria transmetuese gjithashtu pengon zhvillimin e një ekonomie të tregut.

Në përputhje me këtë, KPM, brenda mandatit të vet për të rregulluar transmetimin, përcakton kritere për shërbimet mediale audiovizuale për të vepruar në pajtim me ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërtë dhe praktikat evropiane të pranuara lidhur me pronën intelektuale.

Termet dhe Kushtet e çdo Licence të KPM-së për Transmetim obligojnë shërbimet mediale audiovizuale që të veprojnë në pajtueshmëri me ligjin për të drejtën e autorit. Për të vlerësuar pajtueshmërinë me këtë obligim KPM kërkon prej tyre sigurimin e provave, marrëveshjeve valide, sipas kërkesës.

Për qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë me respektimin e të drejtës së autorit, kjo rregullore përcakton kërkosat e mëposhtme operative për subjektet e licencuara nga KPM-së, shërbimet mediale audiovizuale në Kosovë. Kjo rregullore nuk duhet të shihet si një interpretim i hollësishëm i asaj se çka është e lejuar e çka jo sipas ligjeve dhe akteve nënligjore për të drejtën e autorit.

1. Shfrytëzimi i drejtë i materialit me të drejta të mbrojtura të autorit:

- 1.1 Vetëm për qëllime të raportimit të planifikuar të lajmeve dhe transmetimeve informative ose arsimore, transmetuesit mund të përdorin ekstrakte të arsyeshme të shkurtra të materialit në video, audio ose material tekstuaj që

është objekt i mbrojtjes autoriale sipas ligjit të Republikës së Kosovës për të drejtën e autorit dhe të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e pronës intelektuale, me kusht që ofruesi i shërbimit medial audiovizual i jep atribute të qarta burimit. Në përgjithësi ekstraktet e tillë nuk duhet të tejkalojnë 90 sekonda.

- 1.2. Ky standard i "përdorimit të drejtë" nuk duhet të interpretohet për të lejuar përdorimin e shumëfishtë dhe sekuencial të materialeve të lajmeve të prodhuara nga organizatat tjera në mungesë të një marrëveshje të vlefshme nga pronarët e të drejtave të autorëve të materialeve të tillë ose nga agjentët e tyre të autorizuar. Në asnjë rast "përdorimi i drejtë" nuk duhet të rrezikojë interesat ekonomike apo morale të pronarëve të të drejtave autoriale dhe të drejtave të ndërlidhura.
2. **Transmetimi i pjesëve substanciale ose tërësisë së materialit me të drejta autoriale:**
 - 2.1 Transmetimi i tërësishëm apo i pjesëve të konsiderueshme të materialeve në video, audio ose tekstuale që janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit, duke tejkaluar standaret e Përdorimit të Drejtë të dhëna në nenin 1.1 të kësaj rregulloreje, lejohet vetëm në kuadrin e një kontrate të vlefshme me pronarin e të drejtave të autorit ose me shitësin e autorizuar ligjërisht për materiale të tillë.
 - 2.2 Përveç kërkesës në paragafin 2.1, në lidhje me transmetimin e materialeve video, audio dhe materialeve të tjera të mbrojtura me të drejtën e autorit, KPM kërkon që ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale të marrin të gjitha këto materiale në formë elektronike ose në formë tjera të regjistruara në atë mënyrë që respektojnë detyrimet mbi të drejtën e autorit.

3. Sanksionet

- 3.1 Për mosrespektim të kësaj rregulloreje do të aplikohen sanksionet e përcaktuara me Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media.

4. Data e hyrjes në fuqi: Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Argentina Grazhdani
Kryetare e Këshillit të KPM-së



12.06.2009

Data